



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1945/10 prot.

Datë 16.09.2025

V E N D I M
Nr.1252/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.09.2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Lala Company” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-50072-06-03-2025, me objekt “LOTI 1: “GATIM DHE SHPËRNDARJE E USHQIMIT PËR NJËSINË E SIGURISË PUBLIKE, FIER”, me fond limit me fond limit 67,130,100 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e tridhjetë mijë e njëqind) lekë pa tvsh, ose 682,979.96 (gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) Euro pa tvsh, zhvilluar në datën 04-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Lala Company” SHPK me NIPT K94431401T dhe adresë Lagjia Loni Dhamo, Rruga Uan Kondakçiu, godina nr. 4, Lushnje.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara
Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 04-06-2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-50072-06-03-2025, me objekt “LOTI 1: “GATIM DHE SHPËRNDARJE E USHQIMIT PËR NJËSINË E SIGURISË PUBLIKE, FIER”, me fond limit me fond limit 67,130,100 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e

njëqind e tridhjetë mijë e njëqind) lekë pa tvsh, ose 682,979.96 (gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) Euro pa tvsh, zhvilluar në datën 04-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 04.07.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 14.07.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "LALA COMPANY" sh.p.k	59,883,750 lekë pa TVSH	skualifikuar
2. "S I L V E R" sh.p.k	64,852,500 lekë pa TVSH	kualifikuar

II.4. Në datën 17.07.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

II.5. Në datën 19.07.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1945/2025 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5583 e operatorit ekonomik "*Lala Company*" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar" me Nr. REF-50072-06-03-2025, me objekt "LOTI 1: "GATIM DHE SHPËRNDARJE E USHQIMIT PËR NJËSINË E SIGURISË PUBLIKE, FIER", me fond limit me fond limit 67,130,100 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e tridhjetë mijë e njëqind) lekë pa tvsh, ose 682,979.96 (gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) Euro pa tvsh, zhvilluar në datën 04-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "*Lala Company*" SHPK.

II.6 Në datën 19.07.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1945/1 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5584 e operatorit ekonomik "*Lala Company*" SHPK për procedurën e prokurimit të sipërpërmendur.

II.7. Në përputhje me nenin 112 "*Veprimet paraprake*" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1945/2 prot., datë 21.07.2025, duke publikuar arsyet e skualifikimit të "*Lala Company*" SHPK.

si vijon:

"[...]"

OE "*LALA COMPANY*" S'kualifikohet

Operatori ekonomik "LALA COMPANY" sh.p.k, me Nuis K94431401T, referuar dokumentacionit ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk i përmbush kerkesat e pergjithshme dhe veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT për këto arsye:

I) LALA COMPANY" sh.p.k, nuk plotëson kërkesat e Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, B. PËRGATITJA E OFERTAVE , pika 22 , në lidhje me paraqitjen e ofertës ekonomike sipas shtojcës 2 te DST "Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit", pasi rezulton me gabime aritmetikore te cilat pas korrigjimeve rezultojnë mbi 2% e totalit të korrigjimeve. Konkretisht për dy zërat sipas tabelës të zërave të shërbimit, ofertuesi ka plotësuar gabim kolonen 5

Cmimi Total i shërbimeve, në tabelën e cmimeve që del nga shumëzimin e sasive/kolona 3 me cmimin njësi/kolona 4 e tabelës, ku të dyja nëntotaleve rezultojnë gabim.

Zëri Vakte dreke (figuron ne formularin e cmimit) = 42,952,500 leke, nderkohë që perlllogaritja e sakte eshte =35,793,750 lekë

Zëri Norma FS figuron ne formularin e cmimit) = 28,908,000 leke nderkohë që duhet =24,090,000 lekë KVO kreu korrigjimet e nëntotaleve të këtyre zerave, në zbatim të pikës 22 "Korrigjimi i gabimeve" Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, B. PËRGATITJA E OFERTAVE, ku përcaktohet se: b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin. Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar

Rezultoi se shuma e nentotaleve të paraqitura gabim është =78,746,250 lekë, ndërsa shuma e nentotaleve të korrigjuara është =59,883,750 lekë. Gabimi ne ofertë nga shume e nëntotaleve rezultoi 18,862,500 lekë ose 23,9 % e shumes absolute te të gjitha gabimeve, vlerë më e madhe se vlera e lejuar ne dokumentet e tenderit 2% e shumës absolute të të gjitha korrigjimeve ose 1,574,925 lekë, dhe për këtë asrye oferta e ofertuesit refuzohet.

II) LALA COMPANY" sh.p.k, nuk plotëson kërkesat e vecanta për kualifikim sipas pikës 2.1.1 Seksioni 2.1 "Kapciteti profesional i operatoreve ekonomike", pasi nuk disponon licensën specifike të kërkuar për këto arsye:

Konkretisht në pikën 2.3.6 të KVK në Dokumentat e Tenderit është kërkuar:

2.1.1. Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë "II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz", (katering).

Në lidhje me këtë pikë, operatori ekonomik LALA COMPANY" sh.p.k, ka paraqitur licensën LN-4386-06-2022 (adresë në Bashkinë Fier) me objekt "Prodhim, perpunim e shperdarje me shumice e ushqimeve per njerëz. (Restorant), pra rezultoi se ofertuesi nuk zoteron licesnen me veprimtari "Katering" të kërkuar shrehimisht në Kërkesat e Vecanta në Dokumentat e Tenderit, pasi objekti specifik i veprimtarisë sipas licensës të paraqitur është "Restorant".

II.8. Në datë 23.07.2025 operatori ekonomik “Silver” SHPK ka dorëzuar argumente në Sistemin e ankesave elektronike protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1945/3 prot., datë 23.07.2025.

II.9. Në datë 24.07.2025 operatori ekonomik “Silver” SHPK ka dorëzuar argumente nëpërmjet shërbimit postar protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1945/4 prot., datë 24.07.2025.

II.10. Me shkresën me nr. 1710/10 prot., datë 29.07.2025 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “LALA COMPANY” shpk për procedurën e prokurimit me nr. REF-50072-06-03-2025”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1945/5 prot., datë 30.07.2025 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Lala Company” SHPK, vendimin e KSHA-së nr. 74/2025 nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.11. Me shkresën me nr. 1945/6 prot., datë 04.09.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion”, drejtuar Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar informacionin si vijon: “[.] Në kuadër të shqyrtimit të një ankese, gjatë veprimtarisë tonë, lind e nevojshme ndihma juaj, nëpërmjet informacionit: “Nëse Licenca LN-4386-06-2022, Nuis/Nipt K94431401T, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në emër të shoqërisë Lala Comapny Shpk, adresa 15 Lushnjë, lagjia Loni Dhamo, Rruga Uan Kondakçiu, godina nr. 4, kodi II.1.A.1, data e lëshimit 2022-06-29, kategoria: prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, nënkategoria: prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, veprimtari specifike: prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. (Restorant) a e kryen shërbimin catering?” Bashkëlidhur gjeni fotokopje të licencës LN-4386-06-2022”

II.12. Me shkresën me nr. 5042/1 prot., datë 10.09.2025, me lëndë “Kthim përgjigje shkresës nr. 1945/6 prot., datë 4.09.2025 “Kërkesë për informacion”, protokolluar me tonën me nr.1945/7 prot., datë 12.09.2025 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka informuar si vijon: “[.] Referuar VKM-së nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, për licencat e grupit të tretë (që i përkasin AKU-së) citohet: “Specifikim”, është një klasifikim i standardizuar i kategorisë/nënkategorisë së licencës/lejes, gjithashtu edhe pika 6 e këtij kapitulli parashikon se: sipas kërkesës së tij, një subjekt mund të pajiset, në të njëjtën kohë apo në kohë të ndryshme, me një licencë lidhur me një apo disa specifikime apo specialitete, kur një ndarje e tillë ekziston për atë kategori apo nënkategori, me kushtin që ai t’i plotësojë kriteret përkatëse të lidhura me ndarjet specifike apo specialitetet. Gjithashtu pika 4 e kapitullit II parashikon se: kriteret e hollësishme dhe dokumentet përkatëse provuese janë ato të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për rregullat dhe standartet minimale të kryerjes së veprimtarive elementare përkatëse sipas kategorive, nënkategorive, specifikimeve a specialiteteve.

Pra referuar sa më sipër shpjeguar ky subjekt është licencuar në veprimtarinë specifike: 'Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (restorant), veprimtarinë specifike që në të vërtetë e kryen ky subjekt në fushën e ushqimit'.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të ankimuesit, KPP gjen me vend të sqarojë pozitën e ankimuesit lidhur me pagesën e tarifës financiare për procedurën e prokurimit objekt ankimi. KPP bën me dije se duke qenë se ankimuesi ka aplikuar në sistemin e ankesave elektronike dy herë herë për të njëjtën procedurë prokurimi konkretisht përmes ankesave me nr. ankimi elektronik A/2025/5583 dhe me nr. 1945/2025 prot., datë 21.07.2025 si dhe me nr. ankimi elektronik A/2025/5584 dhe me nr. 1945/1 prot., datë 21.07.2025 me të njëjtën përmbajtje, operatori ekonomik ka ngarkuar mandatat pagesë të ankesave me nr. ankimi elektronik A/2025/5584 dhe me nr. 1945/1 prot., datë 21.07.2025. Ndërsa ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5583 dhe me nr. 1945/2025 prot., datë 21.07.2025 duke qenë se ka të njëjtin mandat pagesë me ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/5584 dhe me nr. 1945/1 prot., datë 21.07.2025 dhe si rrjedhojë statusi i saj është “paparaqitur mandat pagesë” do të koniderohet si ankesë pa pagesë dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP për mos plotësim të kushteve formale sipas legjislacionit për prokurimin publik në fuqi.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Lala Company” SHPK për kundërshimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: *“LALA COMPANY ka shprehur saktë vlerën pa tvsh, tvsh, dhe vlerën me tvsh. Ketu nuk ka asnjë gabim sepse kompania ka dhënë ofertën e sakte, cmimet për njësi janë të sakta. Duke u bazuar në vkm 285 neni 82 pika 3”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike”, të dokumenteve të tenderit, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹

¹ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

III.2.2. Në shtojcën 2 të dokumenteve të tenderit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					

4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

III.2.3. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “Lala Company” SHPK rezulton se, për plotësimin e kërkesës së autoritetit për shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike”, nga ana e këtij operatori është ofruar si vijon:

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: 71,860,500 [shtatëdhjetë e një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind];

III.2.4 Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “Lala Company” SHPK rezulton se, për plotësimin e kërkesës së autoritetit për listën e çmimeve sipas zërave nga ana e këtij operatori është ofruar si vijon:

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	VAKTI DREKE	57,270	625	42,952,500	
2.	NORMA FS (tre vakte)	17,520	1,375	28,908,000	
				Çmimi total	
	Çmimi Neto pa TVSH	59,883,750			
	TVSH (%)	11,976,750			

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.6. Në nenin 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. 2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e

tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën. 3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. 4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.7. Në nenin 82 pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se: “3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin . b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin. c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës .

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi..”

III.2.8. Sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se referuar “Listës së çmimeve sipas zërave të preventivit”, të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Lala Company” SHPK, rezulton, se vlera e ofertuar është 59,883,750 lekë pa TVSH. Ndërkohë referuar çmimit për njësi rezulton se për zërin vakti dreke, sasia 57,270, çmimi për njësi është

625, çmimi total 42,952,500, ndërsa për zërin norma FS (tre vakte) sasia 17,520, çmimi për njësi është 1375, çmimi total 28,908,000 lekë pa tvsh, çmimi neto pa tvsh është 59,883,750 lekë pa tvsh. Ndërkohë që në formularin e ofertës sipas shtojcës 1 të DST çmimi total i ofertës pa TVSH është deklaruar 59,883,750 lekë pa TVSH.

Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk ndodhemi para gabimeve aritmetike në kuptim të nenit 82 pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nga ku nëse do të ishim përballë një fakti të tillë, autoritetit kontraktor i lind detyrimi që të kryejë veprimet procedurale gjatë konstatimit të këtij gabimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi në rast të konstatimeve të tilla. Komisioni gjykon, se në këtë rast kemi mospërputhje mes vlerës së ofertuar nga operatori ekonomik në listën e çmimeve sipas zërave të preventivit, nga kryerja e veprimeve aritmetike të cmimit për njësi dhe cmimit dhe vlerës totale të ofertës të paraqitur në formularin e listës së çmimeve sipas preventivit. Komisioni vëren, se në vetvete ka një llogaritje të qartë e të ndarë të secilit prej zërave të preventivit të përcaktuar në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, duke mos cenuar dhe shkeluar as bazën ligjore në fuqi për sa i përket çmimeve për njësi dhe vlerës totale e cila është 59,883,750 e cila është përlllogaritur referuar çmimeve për njësi dhe sasisë për secilin zë, si dhe është shprehur në formularin e ofertës dhe në formularin e shtojcës së listës së çmimeve sipas preventivit, pra kjo vlerë është e njëjtë me vlerën e deklaruar në formularin e ofertës me shifra dhe me fjalë. Ndodhur në këto kushte Komisioni gjykon, se arsyeja e skualifikimit të KVO-së se: *“LALA COMPANY” sh.p.k, nuk plotëson kërkesat e Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, B. PËRGATITJA E OFERTAVE , pika 22 , në lidhje me paraqitjen e ofertës ekonomike sipas shtojcës 2 te DST “Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit”, pasi rezulton me gabime aritmetikore te cilat pas korrigjimeve rezultojnë mbi 2% e totalit të korrigjimeve. Konkretisht për dy zërat sipas tabelës të zërave të shërbimit, ofertuesi ka plotësuar gabim kolonen 5 [..]”* duke e konsideruar si një gabim aritmetik, nuk ka mbështetje ligjore, pasi nuk ndodhemi në asnjë prej rasteve të përcaktuara në nenin 82, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lidhur me gabimet aritmetike të ofertës. Në këtë kuadër, duke qenë se nuk jemi në kushtet e nenit 82 pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit të KVO-së nuk qëndron. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e lex specialis për prokurimin publik

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Lala Company” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Lala Company” SHPK për kundërshimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: “II) Pra, sic rezulton nga me sipër në DST është kërkuar licence e kategorisë II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë dhe nga ana e shoqërisë LALA COMPANY SHPK është ofruar Licenca me kod II.1.A.1 me numer LN-4386-06-2022 me objekt veprimtarie: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë. Pretendimi se licenca e paraqitur nga OE LALA COMPANY shpk LN-4386-06-2022 ka veprimtari dhe kufizime specifike Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë (Restorant) , pra licenca e paraqitur në këtë procedurë nga subjekti ofertues nuk është në përputhje me fushën specifike të veprimtarisë objekt prokurimi e cila është LOTI 1: GATIM DHE SHPËRNDARJE PËR NJESINË E SIGURISË PUBLIKE, FIER është teresisht abuzive dhe pasi licenca për ofrimin e shërbimit të ushqimit të gatuar nuk mund të jetë e specifikë për çdo rast. Ajo ka objekt të përgjithshëm prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë, i cili përfshin edhe objektin e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit. Fjala katering i referohet shërbimit të ushqimit dhe pijeve për ngjarje të ndryshme, si dasma, festa, konferenca, dhe evente të tjera. Katering mund të përfshijë përgatitjen, transportimin dhe shërbimin e ushqimit dhe pijeve në vendin e ngjarjes. Ky shërbim mund të ofrohet nga restorante, kompani të specializuara në katering, ose individë të pavarur. Pra, katering është shërbim që ofrohet nga restorantet, shoqëri të specializuara apo individë të ndryshëm dhe nuk ka lidhje me objektin e licenses për të cilin është skualifikuar shoqëria LALA COMPANY SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST Shtojca 9 FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT, në pikën 2.1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë përcaktohet si vijon:

2.1.1 *Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë”, (katering). Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).*

III.3.2 Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit operatori ekonomik “Lala Company” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si vijon:

- Licencë LN-4386-06-2022, Nuis/Nipt K94431401T, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, adresa 15 Lushnjë, lagjia Loni Dhamo, Rruga Uan Kondakçiu, godina nr. 4, kodi II.1.A.1, data e lëshimit 2022-06-29, kategoria: prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, nënkategoria: prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve,, veprimtari specifike: prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë. (Restorant).Vendi i kryerjes së veprimtarisë Fier.
- Licencë LN-2299-11-2016, Nuis/Nipt K94431401T, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, adresa 15 Lushnjë, lagjia Loni Dhamo, Rruga Uan Kondakçiu, godina nr. 4kodi II.1.A.1, data e lëshimit 2016-11-09,

kategoria: prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, nënkategoria: prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve,, veprimtari specifike: prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. (Restorant). Vendi i kryerjes së veprimtarisë qarku Fier, rrethi Lushnje.

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” L. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në nenin 3, “Parime të përgjithshme”: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.3.4. Neni 41, pika 4 i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.*

III.3.5. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj” Gjithashtu, në Aneksin 3 “Përmbajtja orientuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emertimi i*

veprimtarise(ve) specifike te licencuara sqarohet se: a) Ketu vendoset emertimi i veprimtarise specifike kur kjo eshte e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kerkuar te ushtroje me shume se nje veprimtari specifike, ketu vendosen emeritimet e te gjitha atyre veprimtarive specifike qe ka kerkuar te licencohen. c) Nese keto shenime kerkojne me shume se 250 karaktere ateherë vihet shenimi: *Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkëlidhur Nr.....*”

III.3.6. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: *“Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.*

III.3.7. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht: *“Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti 4.1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve 5 2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare 6 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve 7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve 8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve. 9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë. 10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë. 11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare.*

III.3.8. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, Kategoria II.1 “Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve”, parashikohet shprehimisht: *1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr. 10.081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. 2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategoritë: a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A; b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B; c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C. 24 3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. 4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.*

III.3.9. Në nenin 17, “Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji. 2. Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse. 3. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna: a) emërtimin e kategorisë /nënkategorisë; b) llojin e veprimtarisë, veprimit apo të së mirës publike e të përdorimit të saj; c) të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën; ç) vendin apo vendet e ushtrimit*

të veprimtarisë, të kryerjes së veprimit apo përdorimit të së mirës; d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë; dh) deklaratën e kërkesit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet); e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato; ë) adresën për komunikim; f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur. 4. QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular. 5. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.

III.3.10. Në nenin 23, “Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: “1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj. 2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna: a) emrin dhe stemën e QKL-së; b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi; c) të dhënat për identifikimin e titullarit; ç) llojin e veprimtarisë, veprimit apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj; d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkategorinë); dh) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimit apo në përdorimin e së mirës publike (nëse ka); e) afatin e vlefshmërisë; ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKL-së dhe vulën përkatëse të institucionit; f) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkategorisë; g) aneksin. 3. Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

III.3.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se në një procedurë prokurimi operatori ekonomik ofertues është subjekti i interesuar të paraqiti ofertën e tij në përputhje me dokumentet e procedurës së prokurimit në përmbushje të të gjitha kriterëve kualifikues. Mosplotësimi qoftë edhe një kriteri të vetëm përbën shkak skualifikimi.

Referuar sa më lart, vërehet, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, (katering).”

Nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertës së operatorit ekonomik “Lala Company” SHPK vërehet se ka ngarkuar në SPE dokumentin Licencë LN-4386-06-2022, Nuis/Nipt K94431401T, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, adresa 15 Lushnjë, lagjia Loni Dhamo, Rruga Uan Kondakçiu, godina nr. 4, kodi II.1.A.1, data e lëshimit 2022-06-29, kategoria: prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, nënkategoria: prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, veprimtari specifike: prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. (Restorant), si dhe dokumentin Licencë LN-2299-11-2016, Nuis/Nipt K94431401T, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, adresa 15 Lushnjë, lagjia Loni Dhamo, Rruga Uan Kondakçiu, godina nr. 4 kodi II.1.A.1, data e lëshimit 2016-11-09, kategoria: prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, nënkategoria: prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, veprimtari specifike: prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. (Restorant).

III.3.12 Referuar dokumenteve të ofertës, ankimesi “Lala Company” SHPK ka paraqitur dy licenca, cituar më sipër, ku konstatohet se Kodi i tyre është II.1.A.1, Kategoria - Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkategoria - Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Veprimtari specifike - Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz., Kod i cili është në përputhje me /kodin e kërkuar në kriterin 2.1.1. *Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, (katering). Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018”, kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet Standarde të Tenderit. Komisioni gjykon se në një procedurë prokurimi subjekti i interesuar të fitojë kontratën me autoritetin kontraktor është operatori ekonomik i cili me ofertën e tij duhet të përmbushë të gjitha kriterit dhe specifikimet teknike të Tenderit. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik “Lala Company” SHPK me arsyetimin se: “LALA COMPANY”sh.p.k, nuk plotëson kërkesat e vecanta për kualifikim sipas pikës 2.1.1 Seksioni 2.1 “Kapciteti profesional i operatoreve ekonomike”, pasi nuk disponon licensën specifike të kërkuar për këto arsye:*

Konkretisht në pikën 2.3.6 të KVK në Dokumentat e Tenderit është kërkuar:

2.1.1. Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, (katering).

Në lidhje me këtë pikë, operatori ekonomik LALA COMPANY”sh.p.k, ka paraqitur licensën LN-4386-06-2022 (adresë në Bashkinë Fier) me objekt “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. (Restorant), pra rezultoi se ofertuesi nuk zoteron licesën me veprimtari “Katering” të kërkuar shprehimisht në Kërkesat e Vecanta në Dokumentat e Tenderit, pasi objekti specifik i veprimtarisë sipas licensës të paraqitur është “Restorant””, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën me nr.

1945/6 prot., datë 04.09.2025, iu drejtuar Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, duke kërkuar informacionin si vijon: “[...] Në kuadër të shqyrtimit të një ankese, gjatë veprimtarisë tonë, lind e nevojshme ndihma juaj, nëpërmjet informacionit: “Nëse Licenca LN-4386-06-2022, Nuis/Nipt K94431401T, Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në emër të shoqërisë Lala Comapny Shpk, adresa 15 Lushnjë, lagjia Loni Dhamo, Rruga Uan Kondakçiu, godina nr. 4, kodi II.1.A.1, data e lëshimit 2022-06-29, kategoria: prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve, nënkategoria: prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, veprimtari specifike: prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. (Restorant) a e kryen shërbimin katering?” Bashkëlidhur gjeni fotokopje të licencës LN-4386-06-2022”. Me shkresën me nr. 5042/1 prot., datë 10.09.2025, protokolluar me tonën me nr.1945/7 prot., datë 12.09.2025 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka informuar si vijon: “[...] Referuar VKM-së nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, për licencat e grupit të tretë (që i përkasin AKU-së) citohet: “Specifikim”, është një klasifikim i standardizuar i kategorisë/nënkategorisë së licencës/lejes, gjithashtu edhe pika 6 e këtij kapitulli patshikon se: sipas kërkesës së tij, një subjekt mund të pajiset, në të njëjtën kohë apo në kohë të ndryshme, me një licencë lidhur me një apo disa specifikime apo specialitete, kur një ndarje e tillë ekziston për atë kategori apo nënkategori, me kushtin që ai t’i plotësojë kriteret përkatëse të lidhura me ndarjet specifike apo specialitetet. Gjithashtu pika 4 e kapitullit II parashikon se: kriteret e hollësishme dhe dokumentet përkatëse provuese janë ato të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për rregullat dhe standartet minimale të kryerjes së veprimtarive elementare përkatëse sipas kategorive, nënkategorive, specifikimeve a specialiteteve.

Pra referuar sa më sipër shpjeguar ky subjekt është licencuar në veprimtarinë specifike: ‘Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (restorant), veprimtarinë specifike që në të vërtetë e kryen ky subjekt në fushën e ushqimit’.

Referuar licencës së ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “Lala Company” SHPK, si dhe shkresës së sipërpërmendur të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Komisioni gjykon se licenca me nr. LN-4386-06-2022 me kodin II.1.A.1, nuk përputhet me objektin e prokurimit “LOTI 1: “GATIM DHE SHPËRNDARJE E USHQIMIT PËR NJËSINË E SIGURISË PUBLIKE, FIER”, dhe nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.1.1 pasi autoriteti kontraktor ka kërkuar licencë për veprimtarinë specifike (katering), ndërkohë licenca e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Lala Company” SHPK ka si veprimtari specifike restorant. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës, përsa kohë janë pranuar prej tyre, në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit Komisioni i Prokurimit Publik, referuar Vendimit të KSHA-së, gjykon se vendimi është i argumentuar drejtë dhe duhet të qëndrojë në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Lala Company” SHPK me nr. ankimi elektronik A/2025/5583 dhe me nr. 1945/2025 prot., datë 21.07.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-50072-06-03-2025, me objekt “LOTI 1: “GATIM DHE SHPËRNDARJE E USHQIMIT PËR NJËSINË E SIGURISË PUBLIKE, FIER”, me fond limit me fond limit 67,130,100 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e tridhjetë mijë e njëqind) lekë pa tvsh, ose 682,979.96 (gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) Euro pa tvsh, zhvilluar në datën 04-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Lala Company” SHPK me nr. ankimi elektronik A/2025/5584 dhe me nr. 1945/1 prot., datë 21.07.2025 për procedurën e prokurimit të mësipërme.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Lala Company” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Florent Zguro

